




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.T.SH. "Elektra"  
Numri i biznesit -80283989  
Pronar – Hebib DERMJANI  
NTSH ELEKTRA  
Adem Jashari pn  
Hani i Elezit

Ref:1807/840/LIC/ni

## VENDIM

*për ripërtitjen e licencës së KPM-së për NTSH Elektra dhe ndryshimin e emrit në Mediakos  
Communications, me seli në Han të Elezit*

---

### Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. NTSH Elektra është operatorë i shpërndarjes, i cili ishte licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audivizuale përmes sistemit kabllorë, me seli në Han të Elezit. KPM, me datën 1 gusht 2008, ka marr vendim për dhënien e licencës për operatorë të shpërndarjes për NTSH Elektra.
3. Me datën 1 gusht 2018, skadon afati i licencës së NTSH Elektra, ndërsa, në bazë të nenit 25 të Ligjit për KPM-në, kandidatit i ofrohet e drejta të kërkojë ripërtitjen e licencës në afat brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.
4. Më 27 mars 2018, Departamenti i Licencimit, pranë Zyrës Ekzekutive të KPM-së, i ka njoftuar të gjithë të licencuarit lidhur me afatet dhe obligimet që parashihen me nenin 25 të Ligjit për KPM, për ripërtitje të Licencës së KPM-së.

5. Më 8 qershor 2018, operatori i shpërndarjes NTSH Elektra ka parashtruar kërkesën në zyrën e KPM-së, me anë të së cilës ka shprehur interesimin për ripërtëritje të Licencës së KPM-së.
6. Më 3 korrik 2018, operatori i shpërndarjes NTSH Elektra ka parashtruar kërkesë për ndryshimin e emrit në Mediakos Communications, ndërsa, subjekti si biznes i regjistruar nuk përbënë asnjë ndryshim.

### Arsyetimi

7. Operatori i Shpërndarjes NTSH Elektra, ka parashtruar kërkesën për ripërtëritje të licencës së KPM-së brenda afatit të përcaktuar ligjor dhe në pajtim të plotë me procedruat e përcaktuara administrative nga KPM.
8. Neni 25 i Ligjit për KPM-në, i cili thekson:

*“Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audiovizuel privat për sa u përket kushteve dhe kriterëve të licencimit, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Zyra Ekzekutive brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës”,*

krijon bazën ligjore që të ripërtërijë licencën e kandidatëve të cilët kanë parashtruar kërkesën për ripërtëritje në pajtim me ligjin për KPM.

Komisioni konstaton se, emri i propozuar për ndryshim të NTSH Elektra në Mediakos Communications, nuk është i ngjajshëm me ndonjë nga emrat e të licencuarëve të KPM-së dhe kërkesa e tillë është e pranueshme.

### Vendim

9. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 1 gusht 2018, në pajtim me Nenin 25 të Ligjit për KPM-në, merr vendim për ripërtëritjen e licencës së NTSH Elektra (sipas emërimit të ri Mediakos Communications), për të ushtruar veprimtarin e shpërndarjes së shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale në Republikën e Kosovës.
10. Komisioni vendos që të ndryshohet emri i operatorit të shpërndarjes NTSH Elektra në Mediakos Communications, sipas kërkesës së parashtruar nga i licencuari.
11. Licenca e KPM-së për operatorin e shpërndarjes NTSH Elektra (sipas emërimit të ri Mediakos Communications) do të jetë e vlefshme në afat prej 10 (dhjetë) viteve, bazuar në Nenin 21, paragrafin 2 të Ligjit për KPM-në, ndërsa, vlefshmëria e licencës do të llogaritet nga data 1 gusht 2018.

12. Të gjitha parametrat e Licencës së KPM-së, shtrirja e rrjetit të operatorit të shpërndarjes NTSH Elektra (sipas emërimit të ri Mediakos Communications), si dhe lista e kanaleve sipas katalogut që është pjesë përbërëse e Licencës së KPM-së, mbesin të pandryshuara nga licenca paraprake.

13. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.



Muja FERATI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



01.08.2019

datë